

KUD 331.24(496.51)

SKEMA PENSIONALE NË KOSOVË: DILEMAT

*MSc. Bashkim Nurboja
bakinurboja@yahoo.com*

Abstrakt

Në Kosovë skema pensionale ka filluar nga pika zero. Modeli i sistemit pensionale është marr nga Kili me rekomandimet e bankës botërore. Shumë shtete këtë e shohin si një model moderne të pensioneve. Ku, stabiliteti fiskal nuk rrezikohet nga vjetërsia e popullatës që është një problem akut në shtetet e zhvilluara, dhe ku mundësohet krijimi i fondeve për investime në tregjet kapitale dhe financiare. Por, në rastin e Kosovës sa është e arsyeshme që të kemi një skemë të tillë? Ne pohojmë që skema pensionale e Kosovës është e qëndrueshme. Që na rastin e Kosovës është Trusti pensionale. Me politizimin e parave të grumbulluara nga Trusti rritet rreziku për të ardhmen e pensioneve.

Fjalët kyçe: Pension, paguaj gjatë procesit (pay as you go), skema investuese (funded sheme)

JEL Klasifikimi: G23, H55.

1. Hyrje

Në Kosovën e pas luftës, tema e pensioneve ka qenë okupim i të gjithëve. Nëse ke qenë pensionist ke mbetur pa pension, nëse nuk ke qenë pensionist ki menduar se si do të mbi jetojë në kohën kur do të pensionohem. Pensioni në shumë shtete shikohet si investimi i dytë më i rëndësishmi pas shtëpisë. Në Kosovë ndër ligjet e para të cilët kanë kaluar në parlament nga Ministria e punës dhe mirëqenies sociale (MPMS), ka qenë ligji për pensione. Ky ligj përbëhet nga tri komponentë dhe është rekomanduar nga Banka Botërore (BB), ku shteti Kilian është marr si model⁴¹. Qëllimi i sistemit pensional në Kosovë ka qenë arritja e disa objektivave:

- Lehtësimi i konsumit duke i lejuar punëtorët të ndajnë të ardhura për vitet ardhshme të pensionimit

⁴¹ Kili ka qenë një ndër shtetet e para të cilët e kanë përdorur formën e skemes investuese (Kursime pensionale)

- Funksionin e sigurimi duke lejuar pjesëmarrësit të sigurohen kundër riskut i.e. pasiguria e jetëgjatësisë, invaliditetit apo përkrahja e të gjallëve nëse vdekja ndodh.
- Rishpërndarja e pasurisë ndër gjenerata dhe brenda gjeneratës, nga të pasurit tek te varfëritë

Megjithatë, se a do ti arrin këto objektiva sistemi pensionale, koha do të tregoj. Në shumë literatura vërehet se intervenimi i shtetit për ti arritur këto objektiva është i domosdoshëm, për shkak të dështimeve të tregut (informatave asimetrike). Shteti i Kosovës duhet të sigurohet së pari që tregu i anuiteteve të ekzistoj, me një konkurrencë të mirëfilltë. P.sh. në Kosovë vetëm kompania sigurimeve Dukagjini është e licencuar për të shitur anuitete. Me një kompani si ofertuese e anuiteteve, mund të supozohet se çmimi do të jetë mbi koston margjinale; që nënkupton që pensionerët do të nën shërbejnë. Këto problem ekzistojnë në skemën pensionale që quhet “investuese” siç për momentin ekziston në Kosovë. Por ekziston edhe formë tjetër e sistemit pensionale që nuk i ka këto probleme por, megjithatë edhe ky sistem ka probleme të natyrave të ndryshme.

Dilema të cilën do të elaborohet në këtë punim është se zgjedhja e Kosovës për sistem investues të pensionit a është e duhur dhe pse politizimi i fondit pensional e rrezikon të ardhmen e pensionit.

Në sesionin e dytë do të shtjellohet literatura për sistemet e pensioneve PAYG dhe “investuese”, rreziqet që ekzistojnë nën këto skema. Në sesionin e tretë do të elaborohet pse Kosovës i konvenon skema “investuese” dhe se si politizimi i fondit pensional rrezikon pensionet. Në fund to të paraqitet konkluzioni.

2. Literatura PAYG vs skemës “investuese”⁴²

Racionaliteti për ofrimin e pensionit në formë private apo nëpërmjet sigurimit social është të ofroj të ardhura gjatë moshës së pensionit. Edhe pse, të ardhurat mund të arrihen nga investimet tjera, në mungesë të pensionit, është vështirë të thuhet se çfarë do të ishin të ardhurat e individit. Qartë, individët do të kishin strategji të ndryshme të akumulimit gjatë jetës në mungesë të pensionit. P.sh. në mungesë të pensionit, pasiguria për jetëgjatësinë, njerëzit që janë risk-avers do të kursenin para më shumë se që është e nevojshme në përgjithësi. Kështu, rreziku nga jetëgjatësi është lindur për ofruesit e pensionit qofshin ata shtetëror apo privat. Veçoria e pensionit është të ofroi të ardhura për ata që pensionohen, megjithatë të ardhurat ndryshojnë nga personi në person. Të ardhurat varen nga kontributi që bëhet në skemën pensionale. Këto kontribute mund të përdoren si investime për konsum të më vonshëm, në rastin e skemës investuese. Apo, në rastin e skemës PAYG këto kontribute përdoren për të

⁴² Në disa literature quhet kursime pensionale, por në këtë punim do të përdoret si term skema investuese.

paguar pensionet e gjeneratës të cilët veç janë duke e gëzuar pensionin. Shihet qartë se ofruesit e pensioneve janë lloj i veçantë i mjeteve të kursimit. Si argument tjetër për ekzistimin e pensionit është rishpërndarjen brenda dhe gjatë gjeneratave, megjithatë, rezultatet e rishpërndarjes janë komplekse dhe të pa qarta (Whitehouse et al. 1994).

Në mënyrë që qeveria me ofrua pension, duhet to ofroj skemë që iu mundëson njerëzve të kontribuojnë dhe t’iu garantojnë benefitet. Edhe pse përfshirja e qeverisë është e rëndësishme, shteti nuk ka nevojë të mbledh kontributet dhe të paguaj benefitet. Shteti mundet me bë legjitim që entitet tjera ta bëjnë këtë detyrë (trusti, bankat, kompanitë e sigurimit etj), por shteti në çdo kohë duhet ti ketë nën vëzhgim këto entitete, sepse dështimet e tregut siç është informatat asimetrike mund të qojnë deri të pasojat sociale.

Zakonisht janë dy lloje sistemeve të pensionit: paguaj gjatë procesit PAYG dhe skema investuese (funded sheme). Në vazhdim do të shtjellojmë për veçorit e secilës.

2.1. Skema pensionale “paguaj gjatë procesit” (ang. Pay-as-you-go)

Skema pensional PAYG përdoret nga shumë shtete në botë. Në këtë skeme pensioni iu paguhet gjeneratës së pensionerëve nga kontributet a punëtorëve të tanishëm nëpërmjet taksave i.e. në mënyrë implicite një pjesë e taksave dedikohet për pension. Në këtë skeme benefitet llogariten duke i ndërlidhur të ardhurat gjatë karrierës. Kjo skemë edhe pse është në përdorim në shumë vende, ekzistojnë shumë shtete që dëshirojnë ta ndryshojnë në skemë “investuese”. Arsyeja primare është raporti i varshmërisë⁴³ si rezultat i ndryshimeve demografike, që mund ta bënë këtë skemë të paqëndrueshme. Kjo do të rezultojë në rritje të shpenzimeve publike, si pasojë e menaxhimit të taksës. Këtë argument do të tentoj ta shpjegoj duke e shfrytëzuar modelin e Barr (2000).

Konsidero skemën PAYG në balancë, ku:

$$sWE=PR \quad (1)$$

Ku s = norma e kontributit në PAYG, W = paga mesatare nominale, E = numri i punëtorëve, P = pensioni mesatar nominal, dhe R = numri i pensionerëve. Në këtë skemë ekziston një ndërlidhje e balancume në mes kontributit momental të punëtorëve dhe pagesave të pensionit.

Për ta ilustruar efektin e ndryshimeve demografike, supozoni që një gjeneratë e madhe punëtorëve në periudhën 1 përcjellët nga një gjeneratë e vogël e punëtorëve në periudhën 2. Në këtë rast, gjenerata e vogël në periudhën 2 duhet ta financoj gjeneratën e madhe të periudhës 1. Nga ekuacioni 1 mund të shohim se nëse kemi zvogëlim të natalitetit, E , atëherë rregullimi i bilancit mund të bëhet në mënyra të ndryshme. Një mënyrë është duke i zvogëluar mesataren e pensionit P duke e bartur koston të pensionerët, por kjo thyen premtimin që i është bërë

⁴³ Njerëzit mbi 65 vjeç pjetu më njerëzit nga 18-64.

pensionerëve. Mundësi tjetër është duke e rritur normën e kontributit ,s, duke e kaluar koston në punëtorët e tanishëm. Por, kjo mund të shkaktoj efekt nxitës avers në punë si shkak i efektit të zëvendësimit. Alternativa mund të arrihet duke bërë ndryshime në dy anët e ekuacionit 1. Barr (2000) sugjeron që ligjet duhet të dizajnohen që të inkurajojnë rritjen e produktivitetit për punëtorë. Kjo mund të arrihet në dy mënyra:

1. Rritja e mesatares së pagës nominale W (në ekuacionin 1)- kjo arrihet duke
 - Ofruar teknologji më të avancime nga e cila mund të rritet outputi për punëtor, apo
 - Mundësi për punëtorë të fitoj njohuri të reja relevante për punën e tyre me anë të edukimit
2. Rritja e ofertës së punëtorëve, E, që mund të arrihet duke:
 - Duke shtyrë moshën e pensionimit
 - Ofruar kushte më të mira për femrat e martuara

Si rezultat i mundësisë për të perfeksionuar skemën pensionale PAYG shumë ekonomist preferojnë këtë skemë nga ajo investuese. Stiglitzi dhe Orszag (1999) argumentojnë se dëshira që të ndryshojnë skemën nga PAYG në atë investuese nuk ka bazë të qartë teorike. Sipas Feldstein (1995) pohimi që skema investuese është superiore ndaj asaj PAYG është e gabueshme sepse neglizhohen kostot e tranzicionit nga një sistem në tjetrin. Për ta bërë këtë qeveria duhet të mendojë se si të paguaj pensionerët që veç janë në PAYG. Që ta bëjë këtë qeveria duhet të rritë taksat apo të lëshon obligacione. Kjo nënkupton që kosto është e pashmangshme sepse dikush duhet ta paguaj tranzicionit. Më shumë, Boldrini et al. (1999) pretendon se PAYG sistemi është i domosdoshëm për arritjen e efikasitetit dhe qëndrimin e rritjes në periudhë afatgjatë. PAYG skema është më përshtatshme për individët me të ardhura të vogla apo ata që kanë qenë të papunësuar gjatë karrierës.

PAYG skema e cila ekziston në shumë shtete është shumë e vështirë që do të ndryshohet në atë investuese për arsye të kostove të tranzicionit. Megjithatë, më disa ndryshim, PAYG skema do të luajë ende një rol të rëndësishëm në shumë shtete.

2.2 Skema pensionale “investuese” (ang. funded scheme)

Skema pensionale investuese nënkupton një llogari individuale ku punëtori kontribuon një përqindje fikse nga të ardhurat. Shuma e parave që akumulohet në këtë fond investohet në tregje të kapitalit apo në obligacione shtetërore, kjo varret nga niveli i risk-aversionit të menaxhmentit të fondit. Në kohën e pensionimit, pensioni i secilit pensioner përcaktohet nga shuma se është kontribuar në fond në emër të tij, plus të gjitha të ardhurat që janë akumuluar si

=====
 pjesë e investimit të fundit pensional⁴⁴. Nga kjo shihet se për dallim nga PAYG skema investuese e tejkalon problemin e ndryshimit në demografi duke e ndërlidhur kontributin me benefitet. Kështu që, në kohën e pensionimit individ mund ta blejë anuitetin më shumë e tërësishme që është akumuluar në llogarinë e tij. Si skemë pensionale e ashtu quajtur investuese është bërë shumë e dëshirueshme sepse duket që mund të ballafaqohet me qëndrueshmërinë që në skemën PAYG kishte dyshime. Nuk është veç ndryshime demografike që e rrite nevojën për skemën investuese, ka më shumë arsye. Feldstein dhe Rangelova (2001) argumentojnë se nën skemën investuese individët mund ti plotësojnë preferencat duke qenë në gjendje që të alokojnë pasurinë e tyre të pensionit në asete të ndryshme. Për më shumë, Feldstein (1995) ofron listën e kushtëve nën cilat ndryshimi nga PAYG në atë investuese do ta rritë mirëqenien sociale: (i) normë të rritjes së ekonomisë, (ii) norma e kthimit në kapital më e madhe se norma e rritjes së të ardhurave nacionale, (iii) norma e kthimit në kapital më e madhe se norma e kohës së preferencave. Ka evidenca [Aaron (1966), Feldstein (1995), Hemming (1998), Miles (2000) Barr and Diamond (2006)] që tregojnë se kushti (i) dhe (ii) lehtësisht plotësohen. Shumat e mëdha të kursimeve privat drejt tregjeve financiare në dekadën e fundit sugjerojnë që edhe (iii) qëndron. Arsye tjetër për skemën investuese është se kostot e pensionit në të ardhmen mund të llogariten lehtësisht. P.sh. në skemën investuese në momentin e fillimit të kontributit fitohet e drejta për pension, kështu norma e kontributit e reflekton të drejtën e fituar për pension.

Edhe pse kjo skemë duket e dëshirueshme, ka shumë rreziqe që ndeshemi nën këtë skemë:

Rreziku nga tregu i anuiteteve: nën skemën investuese, individ mund të blenë anuitetin me shumë e mbledhur në llogari të tij, megjithatë, kjo varet nga pritshmëria e periudhës së pensionimit (jetëgjatësia në kohën që individ del në pension) dhe norma e interesit që kompania e sigurimit pret të fitojë. Këto variabla janë shumë të pa sigurta. P.sh. dy individ me të ardhura të njëjta dhe kontribute mund të përfundojnë me pensione të ndryshme, varësisht nga norma e interesit në kohën e pensionimit. Siç Callund (1999) ka llogaritur për Kilin, kolapsi i normës së interesit në kohë afatgjate në vitet 1996-1998 ka pasur efekt dramatik në normën e anuitetit. Pastaj kemi rrezikun nga inflacioni që mund ta ulë vlerën e akumuluar, megjithatë, gjatë kohës së kontributeve në fond, menaxherat e fondit mund të përdorin instrumente financiare për tu mbrojtur nga inflacioni. Por, pasi që anuiteti blehet, mbrojtja nga inflacioni në kohën pas-pensionimit është e pa kompletim dhe e shtrenjtë. Miles (2000) sugjeron që kontrata efiçente e anuiteteve e rrite mirëqenien.

Rreziku i investimit: në skemën investuese të gjithë risku bie mbi vetë kontribuuesin. P.sh. gjatë investimeve të parave të akumuluar kemi përformim të mirë të fondit, atëherë fondi juaj do të rritet, por në rast se investimet

⁴⁴ Fondi i akumuluar mund të diversifikohet në portfolio të ndryshme p.sh. obligacione, aksione etj. Atëherë nga këto investime do të reflekton niveli i pensionit në kohën e pensionimit.

përformojnë dobët fondi juaj do të zvogëlohet. Miles (2000) duke shfrytëzuar të dhëna historike nga tregu letrave Evropian tregon që disa grupmosha do të fitojn shumë pak apo ndoshta edhe do të kenë kthim negativ.

Kosto administrative: zakonisht këto shpenzime konsiderohen si sekondare sepse njerëzit fokusohen në performancën e aseteve. Megjithatë, James et al. (2001) ka llogaritur që shpenzimet administrative duket që zvogëlon pensionin për 15 deri 30 përqind. Sipas James rreth gjysma janë shpenzime të marketingut, dhe një pjesë e madhe është komision. Poashtu, zvogëlim në pension ndodhë nëse ndaloni të kontribuoni për shkak të papunësisë, sëmundjes apo invaliditetit. Kjo ndodhë se shpenzimet administrative nuk ndalojnë edhe nëse ndalojnë kontributet.

Nga këto mund të shohim se asnjë skemë nuk është imune ndaj riskut. Megjithatë, skema investuese është më dëshirueshme në këtë dekadën e fundit për shkak se e tejkalon problemin e ndryshimeve në demografi. Më shumë, fondet e mbledhura nga skema investuese kanë luajtur rolë shumë të rëndësishëm në tregjet financiare. Poashtu, në skemën investuese njerëzit mund të përcjellin kontributet të cilat i bëjnë dhe ti konsiderojnë si asete që do ti shfrytëzojnë gjatë pensionimit. Megjithatë, skema investuese përballet me problemet që i përmendem: tregu i anuiteteve, risku nga investimet dhe nga shpenzimet administrative.

3. Skema pensionale në Kosovë

Në Kosovë skema pensionale është e ndërtuar prej tri shtylla. Shtylla e parë⁴⁵ konsiderohet si skeme e Beveridge ku të gjithë njerëzit që arrijnë moshën e pensionit, 65 vjet, duhet të kenë drejt në pensionin shtetëror. Ky nivel i pensionit në Kosovë deri vonë ka qenë 40 euro, ku është parapa që të siguroi vetëm 2100 kaloritë e nevojshme ditore për një person. Arsyeja për këtë përfitim të sheshtë për të gjithë që arrijnë moshën 65 vjet se sa veç atyre që kanë kontribuar në skemën pensionale të Beogradit është bazuar mbi disa implikime: mbulim i përgjithshëm për ata që rrallë kanë qenë të paguar; plotësimi i principit të komponentës së parë, shmangia nga varfëria. Megjithatë, kjo shtyllë përbën janë të ulëta 2 % të GDP në krahasim me shtetet e OECD që shpenzojnë nga 10% deri në 20% të GDP (Snelbecker 2005). Shtylla e dytë e cili konsiderohet si më i rëndësishmi ku punëtorët duhet të kontribuojnë 5% të pagës bruto dhe në të njëjtën kohë ky veprim duhet të ndodhë edhe nga punëdhënësi me 5%. Kjo përqindje mund të rritet deri në 15% nga punëtori dhe 15 nga punëdhënësi në mënyrë vullnetare, por 5% është obligues me ligj. E fundit, shtylla e tretë është forma më pak e zhvilluar në Kosovë që quhet pensioni suplementar, kjo bëhet në baza vullnetare. Ky kontribute në Kosovë mund të bëhet në trustin pensional apo edhe në kompanitë private të cilat janë të licencuar nga Banka qendrore për mbledhjen e pensionit suplementar.

⁴⁵ Në këtë punim bëhet analiza për shtyllën e dytë e cila konsiderohet më e rëndësishmia.

Duke u nisur nga struktura e popullsisë së Kosovës që shihet ne tabelën 1, që persona mbi 65 vjeç janë diku rreth 4.7%, ndërsa 63% janë të moshës së punës (Riinvest 2005). Sipas Riinvestit (2005) norma e rritjes së popullsisë 1.6-1.8 % për vit, ku deri në 2015 numri i Kosovarëve pritet të arrijnë në 2.4 milion. Edhe pse Kosova ka normën e rritjes më të madhe nga shtetet OECD, megjithatë norma e rritjes ka filluar të zvogëlohet (shif. Fig 1). Kjo është një ndër faktet se skema PAYG nëse jo tash në të ardhmen do të shkakton probleme financiare mbi buxhetin e Kosovës. P.sh. nëse sot raporti i varshmërisë kishte me qenë 11 punëtor për 1 pensioner sipas llogarive të UNMIK-ut (shif. Tabelen 2) tregon që me zvogëlimin e normës së rritje së popullsisë ky raport do të zvogëlohet. Si rezultat i kësaj nëse e shikojmë ekuacionin 1 atëherë qeveria duhet të ngrit taksat për gjeneratat e ardhshme që të jetë në gjendje të paguaj pensionet për punëtorët që punojnë në këtë kohë.

Problem tjera që do të shkaktoheshin nëse skema PAYG kishte me qenë në funksion është se raporti shumë i madh në mes atyre që punojnë dhe pensionerëve do të detyronte qeverinë që të krijoj një fond akumulues, ku do të menaxhohet nga qeveria e cila çdo herë është vërtetuar se objektivat janë rizgjedhja në qeveri se sa mirëqenia e popullatës. Për ma shume, punësimi informal do të ndikonte në mënyrë të kundërt punëtorët formal. P.sh. kur qeveria i bën planifikimet sa para i nevojiten të financoj pensionerët, qeveria bazohet në punëtorët formal të cilët paguajn taksa, deri sa ata informal i shmangën taksës, atëherë baza e taksës rritet për këta formal dhe kështu kjo ndikon që punëtorët formal të kalojnë në punësim informal, që në mënyrë më i shmang asaj takse.

Table 1. Struktura e popullsisë në Kosovë

Përshkrimi	Numri	Përqindja
Popullata*	2.500.000	100%
Prej 0-15 vjeç	807.500	32.3%
Prej 16-64 vjeç	1.575.000	63.0%
Mbi 65 vjeç	117.500	4.7%
Popullata në Kosovë	2.050.000	100%

* Përfshirë edhe ata që kanë emigruar
Burimi: Vëzhgimi i shtëpiave, Dhjetorë 2002

Number of live births that average women gives during her life




Figura 1. Numri i lindjeve që mesatarisht një femër bën gjatë jetës saj.
Burimi: llogarit e Riinvest

Tabela 2. Parashikimi i numrit të pensionerëve

Viti	2001	2005	2010	2015	2020	2025	2030	2035	2040	2045	2050
Mbi 65 vjeç	131,548	146,436	175,732	209,529	249,456	297,499	334,890	374,888	427,772	500,032	586,085
Pjesë e popullatës	5.8%	6.0%	6.6%	7.4%	8.2%	9.1%	9.6%	10.0%	10.7%	11.9%	13.2%

Burimi: llogarit e UNMIK-ut

Skema pensionale “investuese” në anën tjetër nuk ndikohet nga ndryshimet demografike që nga figura 1 shifet se nuk është immune. Megjithatë, në rrethanat e Kosovës ku pas luftës, institucionet kanë qenë në formim sipër skema investues e detyron qeverinë që të ndërtojë një entitet të pavarur në mirëbesim “Trust” të kontribuesve. Sipas ligjit ky entitet e ka shumë qartë se ku dhe në çfarë asete i lejohet të investoj. Në këtë skemë, nga perspektiva e qeverisë është më mirë se risku ka kaluar në anën e kontribuesve, të cilët nëse investimit nuk ofrojnë kthim të mirë atëherë kjo do të reflekton në pensionin e tyre në të ardhmen, apo e kundërta nëse ofrojnë kthim të mirë ata do të shpërblehen me pension të mirë në të ardhmen. Tjetra, pasi që rrjetin e sigurimit social e mbulon shtylla e parë, shtylla e dytë apo skema investuese bazohet në parimin se sa kontribuon aq edhe do të përfiton kur pensionohesh që në parim është një zgjedhje e drejtë.

Nëse e shikojmë historinë e pas luftës dytë botërore në Kosovë asnjë gjeneratë nuk e ka përjetuar pensionin deri në fund për shkaqe politike. Kjo mund të ndikon në besimin e popullatës dhe ti bëjnë ata që kursimet ti bëjnë në mënyrën individuale a jo duke u bazuar në sistemin pensional. Ndërsa, me

=====

skemën pensionale ku kontributet regjistrohen dhe kthimet apo humbjet nga investimet evidentohen dhe në fund të vitit secili kontribues e merr pasqyrën e vet dhe sheh se pasuri që do ta shfrytëzon në të ardhmen iu ka akumuluar. Kjo kontribuesin do të bënë që të ndihet më konfident për vazhdimin e kontributeve dhe zvogëlon mundësin për kalim në punësim informal. Për më shumë, të dhënat e ndryshme botërore tregojnë që kthimi nga investimet, mesatarisht, është më i madh se norma e rritjes së pagës nominal, që na tregon përfitimit nga skema investuese janë më të mëdha se sa nga skema PAYG. Shume nga këto fakte tregojnë se skema investuese është shumë më e preferuar në rastin e Kosovës se sa PAYG.

Fondet e mbledhura në skemën investuese nuk konsiderohen si fonde për zhvillimin ekonomik të vendet, edhe pse shpesh qeveritë tentojnë ti shfrytëzojnë për atë qëllim. Fondet duhet të kenë objektiv kontribuesin dhe mirëqenien e tij. Në rastin e Kosovës politizimi i fondit pensional e rrezikon pensionet. Duke u nisur nga ligji për pensione që e përcakton çfarë kushte duhet të plotësohen për investim të fondit dhe obligimet ndaj kujdestarëve të këtij fondi, që investimet duhet të bëhet vetëm në ato kompani që janë të regjistruara në tregje të kapitalit nëpër vendet e OECD dhe që janë të ranguar nga agjencitë e vlerësimit të riskut me një risk jo më të ultë se A dhe mund të investohet në instrumente tjera p.sh. obligacione apo bona te thesarit etj. Por të gjitha investimet paraprakisht duhet ta kenë vlerësimin riskut nga agjencitë e riskut. Në Kosovë nuk ekziston tregu i kapitalit, ku kompanitë mundën me u regjistrua dhe të dhënat me qenë transparente. Në Kosovë nuk ekziston asnjë mundësi për investimin këtyre fondeve, për pos në Bankat komerciale. Andaj, me politizimin e fondit ku ngritën zërat se fondi duhet të investohet në Kosovë dhe ti kontribuojë zhvillimit ekonomik, pa u krijuar kushtet, jo vetëm ato elementare që plotësojnë nevojat ligjore, por duhet të krijohen kushtet që përfitimit e fondit të korrespondojnë me riskun.


Komentet që shpesh dëgjohen nga politikanët është se parat duhet të kthehen dhe të depozitohen në banka. Kjo do ta rritet ofertën e parave dhe do të ndikojë në uljen e normës së interesit, dhe në vazhdim do të kemi rritje të investimeve dhe kjo do të ndikojë në rritje ekonomike. Kjo retorik se si politikanët e shohin rritjen ekonomike mësohet në lëndën Makroekonomia në studimet deri diplomime. Por, të gjithë nuk marrin parasysh se ky model në këtë lëndë shpjegohet “caeteris paribus”. E në Kosovë shumë gjëra (infrastruktura ligjore, produktiviteti, inovacionet etj) tjera duhet të përmirësohen që do ta zvogëlofshin normën e interesit. Kemi shembullin e fundit ku qeveria i sjelli 300 milion nga fondi i privatizimit dhe norma e interesit nuk ndryshoj fare. Ndërsa, parat e mbledhura në fond pensional që objektiv e kanë akumulimin sa më të madh për përfitime të kontribuesve duhet të investohen në ato vend dhe në ato asete ku përfitimet janë sa më të mëdha duke e marr parasysh riskun.

Rreziqet që mund të vijnë nga politizimi i fondit që kërkon të investohet brenda Kosovës janë zvogëlimi i pasurisë kontribuesve duke e marr parasysh koston oportune, dhe zhvendosja e të punësuarve formal në punësimin informal.

P.sh. edhe pse është vështirë të parashohim të ardhme, në mënyrë hipotetike mbi disa supozime mund të parashohim të ardhurat e një pensionerët në çmimet e sdit.

Supozimet

- Të ardhurat vjetore 2640€ (220€ mujore, paga mesatare në Kosovë)
- Rritjet nga investimi: Pensioni juaj do të rritet nga 7% në vjet deri në kohën kur pensionoheni
- Inflacioni: Indeksi i çmimeve të konsumit (CPI) do të rritet nga 2.5% për vjet deri sa të pensionoheni
- Rritja e kontributit tuaj çdo vjetë do të rritet nga 2.5%
- Jetëgjatësia pas pensionim në moshën 65 vjeç është 14 vjet.



*Figura 2. Llogaritja e pensionit në çmimet e sdit
Burimi: Llogaritur nga unë*

Sipas figurës 2 mund të shihet se punëtorët që iu kanë bashkangjitur trustit në moshën 40 vjeçare, kur të pensionohen do të marrin pension 92€ në muaj me çmimet e sdit, kjo shumë është 42% e pagës së sotme. Po ashtu, në fig.2 mund të shihet edhe për gjenerata të ndryshme. Kjo tregon se gjenerata që sot punon dhe është e vetëdijshme se pensioni në të ardhmen vështirë që do ti mbulon nevojat e tyre në kohën e pensionit. Kjo llogari hipotetike po supozon se rritja reale e investimit është 4.5%, që është shumë optimale duke e pasur parasysh nivelin e riskut. Por, nëse i kthehemi kërkesës së politikanëve që parat e fondit të kthehen në Kosovë dhe të investohen në Bankat komerciale që maksimumi i interesit në depozita që do ta paguajnë bankat janë 5.7% në vlerë nominale. Që nëse shikohet në vlera reale, duke e marrë parasysh inflacionin e

=====

këtyre viteve të fundit, investimet do të kishin kthim negativ. Kjo si rezultat do të detyronte kontribuesit që të gjejnë mënyrë të shkëputen nga ky fond, i cili jo që nuk është duke e rritur fondin por është duke e zvogëluar. Si pasojë pensionet do të rrezikohen sepse fondi i kontribuesit do të zvogëlohet dhe kjo do të shtyj kontribuesin që të kaloj në punësim informal, në mënyrë që ti menaxhoj kursimet vetë për të ardhmen.

Përfundimi

Skema pensionale është shumë e rëndësishme për një shoqëri, por ndryshimet që ndodhin në demografi dhe në ekonomi i kanë dhënë rëndësi edhe organizimit të skemës pensionale. Paraqitem se modeli i vjetër i skemës pensionale PAYG edhe pse është në përdorim nga shumë shtete po tentohet të përmirësohet apo ndryshohet skemën investuese.

Në skemën PAYG ndryshimet në demografi kanë luajtur një rolë të rëndësishëm, ku në shumë shtete ka shkaktuar jostabilitet financiar, sepse me vjetërsinë e popullatës shpenzimet buxhetore të shtetit janë ngritur shumë. Si alternativ, paraqitet skema investuese, ku i tejkalon problemin e demografisë por megjithatë edhe kjo skemë i ka riskun e vetë siç janë: tregu i anuiteteve, risku investimeve dhe kostot administrative.

Megjithatë, Kosova si një shtet i ri që si dilemë cilën skemë ta përdorë është vendosur për skemën investuese si model modern për pensione. Ku ne edhe mund të pohojmë se është vendim i duhur për arsye se as Kosova nuk është immune ndaj ndryshimeve demografike, ku gjeneratat do të fillojnë të vjetërsohen dhe kjo skemë e tejkalon këtë problem. Për ma shumë, kjo skemë si e tillë është e ndarë nga vendimet shtetërore dhe si objektiv kryesorë ka kontribuesin.

Ndikimet politike se fondi investues duhet të investohet në Kosovë rrezikon pensionet në të ardhmen dhe nuk do të ndikojë në rritjen ekonomike deri sa nuk të përmirësohen parametrat tjerë që i nevojiten një ekonomie të mirëfilltë. Për më shumë, nëse fondi pensional investohet në Bankat komerciale në Kosovë ku në kthim real të investimeve do të jetë negativ kjo do të rrezikon zhvendosjen e të punësuarve nga punësimi formal në atë informal.

Literatura

Aaron, H. J. (1966), "The social insurance paradox", *Canadian Journal of Economics and Politics Science*, vol. 32, pp. 371-4.

Barr, N. (2000) "Reforming Pensions: Myths, Truths, and Policy Choices",. IMF Working Paper No. 00/139

Barr, N., and Diamond, P. 2006 "The Economics of Pensions" *Oxford Review of Economic Policy*

Boldrin, M., Dolado, J., Jimeno, J., and Peracchi, F., (1999) "The Future of Pension Systems in Europe: A Reappraisal," *Economic Policy*, forthcoming.

Callund, D (1999), "Chile: Controversy, Difficulty and Solutions," *The Geneva Papers on Risk and Insurance-Issues and Practice*, Vol. 24, pp. 528-33.

Feldstein, M. (1995). "Would Privatizing Social Security Raise Economic Welfare?," NBER Working Paper No. 5281.

Feldstein, M and Rangelova, E. (2001), "Individual Risk in an Investment-Based Social Security System," *American Economic Review*, 91, 4, 1116-1125.

Hemming, R., (1998), "Should Public Pensions be Funded?,". IMF Working Paper No. 98/35

James, E., James, S., and Vittas, D. (2001). "Administrative Costs and the Organization of Individual Retirement Account Systems: A Comparative Perspective." in *New Ideas About Old Age Security*, ed. R. Holzmann and J. Stiglitz, Washington DC: World Bank.

Miles, D (2000) "Funded and Unfunded Pension Schemes: Risk, Return and Welfare",. CESifo Working Paper Series No. 239.

Orszag, P., and Stiglitz, J., (1999) "Rethinking Pension Reform: Ten Myths About Social Security Systems" *The World Bank, Averting the Old Age Crisis: Policies to Protect the Old and Promote Growth* (Oxford University Press: Oxford, 1994).

Riinvest (2005) "Profili Socio-Ekonomik i Kosovës dhe Sfidat e Zhvillimit" Instituti për hulumtime

Snelbecker, D., (2005) "Pension Reform in Eastern Europe and Euroasia: Experiences and Lessons Learned",. USAID Workshop for Practitioners on Tax and Pension Reform Washington, D.C., June 27-29, 2005

Whitehouse, E., Dilnot, A., Johnson, P., and Disney, R., 1994 'Pension Policy in the UK: An Economic Analysis',. The Institute for Fiscal Studies.

World Bank (2001) "Kosovo, Federal Republic of Yugoslavia: Economic and Social Reforms For Peace and Reconciliation",. Report No. 21784-KOS